



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

## **KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**

**Komiteti për Politikë dhe Financa**

**Nr. 02-060/01-0051646-1/25 dt. 25.08.2025**

**Mitrovicë**

### **PROCESVERBAL**

**Nga mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa**

**Mbledhja e 44-të**

**Koha:** 25.08.2025 ora 10:00  
**Vendi:** Salla e Mediave  
**Të pranishëm:** Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja  
Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Fadil Veseli, Vesel  
Neziri, Erseka Barani, Muhamed Hoti dhe Xhyljeta Imeri  
Drejtorët e Drejtorive  
**Mungoi:** Nazmije Sejdiu dhe Shkurta Shosholli Musa

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja e cila theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11, paragrafi 1 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë; nenit 62, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës, nenit 13, të Rregullores të Punës të Kuvendit të Komunës Nr. 12/2013, për sot ka thirrur mbledhjen e 44-të të Komitetit për Politikë dhe Financa, me këtë:

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Shqyrtimi i kërkesave të OJQ-ve për përkrahje financiare

**Rendi i ditës u miratua unanimisht (6-për, 0-kundër dhe 0-abstenime).**

### **Pika 1**

**Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht (6-për, 0-kundër dhe 0-abstenime).**

## Pika 2

Kryesuesja e Kuvendit para se të hap diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës theksoi se në Zyrën e Kuvendit kanë ardhur: Kërkesa e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së – Mitrovicë, për përkrahje financiare, Kërkesa e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së – Mitrovicë, për përkrahje financiare, Kërkesa e Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së – Mitrovicë, për përkrahje financiare, Kërkesa e OJQ-së “Zëri i Prindërve” për përkrahje financiare, dhe Kërkesa e Shoqatës Down Syndrome Kosova – Mitrovicë për përkrahje financiare.

Igballe Islami: Nëse këto kërkesa miratohen nga Kuvendi i Komunës dhe konfirmohet ligjshmëria e tyre ne do t’i gjejmë mjetet financiare për t’iu dalë në ndihmë.

Fahri Jashari: Shoqata Down Syndrome Kosova – Mitrovicë është subvencionuar nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport me thirrjen e fundit publike, nëse iu intereson shuma e saktë e mjeteve që janë përkrahë dhe projekti, ne jemi të gatshëm t’ua sjellim, ndërsa sa i përket përkrahjes financiare të këtyre organizatave në këtë formë, kjo nuk është e drejtë, nuk është ligjore.

Nazmi Jashari: Ndarja e subvencioneve deri në 500 € është e lejuar me Rregulloren e MF-së Nr. 04/2017.

Xhyljeta Imeri: Unë propozoj që për shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së të krijohet një fond i veçantë ose të kenë një mbështetje të përhershme, e jo të detyrohen çdo herë të kërkojnë mbështetje, sepse këto shoqata kanë shumë aktivitete dhe po ashtu roli i tyre është shumë i rëndësishëm. Ndërsa sa i përket dy kërkesave tjera, më intereson të di pse ende nuk është bërë thirrja publike nga DMS-ja për ndarjen e subvencioneve, kur dihet se jemi në fund të muajit gusht.

Fadil Veseli: Edhe unë jam që shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së t’i bëhet në zgjidhje e përhershme e mos të detyrohen të bëjnë kërkesa për ndihmë me një shumë kaq minimale.

Erseka Barani: Edhe unë jam që në parim t’iu ndihmohet këtyre shoqatave, ekzekutivi duhet të gjejë zgjidhjen e duhur, është e papranueshme pse DMS-ja akoma nuk ka bërë thirrja publike për subvencionim.

Vesel Neziri: Unë nuk e di pse duhet të diskutojmë në këtë formë kur është fjala për organizatat e dala nga Lufta e UÇK-së, drejtor kërkoj nga ju që sa më shpejtë të gjeni formën për me i subvencionuar këto organizata e jo tërë vitin të mos subvencionohen me asnjë cent, mua po më vjen turp edhe nuk kisha mundur me qenë i qetë në karrigen e drejtorit i cili qe disa herë tha nuk bën të subvencionohen, për 500 euro të bëhet kjo zhurmë, vërtetë është turp, ndarja e subvencioneve deri në 500 € është e lejuar me Rregulloren e MF-së Nr. 04/2017, prandaj këto shoqata të subvencionohen me shumën e kërkuar.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim:

- Kërkesën e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së – Mitrovicë, për përkrahje financiare.
- **Komiteti për Politikë dhe Financa miraton unanimit (6-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) Kërkesën e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së – Mitrovicë, për përkrahje financiare dhe e njëjta i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

- Kërkesën e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së – Mitrovicë, për përkrahje financiare.
- **Komiteti për Politikë dhe Financa miraton unanimit (6-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) Kërkesën e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së – Mitrovicë, për përkrahje financiare dhe e njëjta i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**
- Kërkesën e Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së – Mitrovicë, për përkrahje financiare.
- **Komiteti për Politikë dhe Financa miraton unanimit (6-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) Kërkesën e Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së – Mitrovicë, për përkrahje financiare dhe e njëjta i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**
- Kërkesën e OJQ-së “Zëri i Prindërve” për përkrahje financiare,
- **Komiteti për Politikë dhe Financa miraton unanimit (6-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) Kërkesën e OJQ-së “Zëri i Prindërve”, për përkrahje financiare dhe e njëjta i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.**

Ndërsa Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri konstatoi se Shoqata Down Syndrome Kosova – Mitrovicë këtë vit përmes thirrjes publike është subvencionuar nga DKRS-ja, dhe po ashtu në kërkesë nuk e ka cekë shumën e mjeteve financiare me të cilën kërkon të përkrahet.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 10:50 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:

  
Merita PRETENI

Kryesuesja e Kuvendit

  
Vesa BROJA

